

**PKR.nr. 287/15**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.B. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Dhënie e ryshfetit nga neni 344 par. 1 të KPK, i akuzuar sipas Propozim Akuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.I.nr.81/2013 të datës 29.04.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 27.10.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Rrahim Podvorica dhe të pandehurit A. B., me datë 27.10.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri A. B.,** nga i ati E. dhe nëna Sh., e gjinisë K., i lindur më *data e lindjes...* në P., i pamartuar, student, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse, me datë 27.12.2012 rreth orës 12.55 në Prishtinë, në rrugën “Arkitekt Karl Gega”, i gjatë levizjes me veturën e tipit “BMW 530” ngjyrë të gjelbërt, me targë regjistrimi *numër i targave...*, është ndaluar nga njesia patrolluese e trafikut dhe i janë kërkuar dokumentet, mirëpo i njëjti në mungesë të patent shoferit, personit zyrtar-polici, ia ofroi një monedhë prej dhjetë (10) euro, me qëllim që personi zyrtar-polici, të kryhej një veprim zyrtar në kundërshtim me kompetencat e tij zyrtare,

- me çka ka kryer veprë penale Dhënie e ryshfetit nga neni 344 par. 1 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 6, 11, 15, 34, 64,74,75 të KPK dhe neneve 248 par.4, 365, 366 dhe 498 të KPP, i shqipton,

### **VËREJTJE GJYQËSORE**

Me të cilën i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale dhe, nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do t'i shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri detyrohet t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës si dhe paushallin gjyqësor, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të marrë formën e prerë,

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me Propozim Akuzën PP.nr.18/2013 të datës 29.04.2014, ka akuzuar të pandehurin A. B., për veprë penale Dhënie e ryshfetit nga neni 344 par. 1 të KPK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara, në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, në departamentin përkatës, duke vepruar sipas propozim akuzës së lartshënuar në këtë çështje penale, ka mbajtur shqyrtim fillestar, në të cilin i pandehuri A. B., i vënë në dijeni të plotë për natyrën, përparësitë dhe pasojat e pranimit të fajsisë, vullnetarisht pranoi fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, duke theksuar se ishte ndier i frikësuar nga polici por edhe nga prindi i tij meqë ishte në moshë të re, pranon se ka gabuar, shpreh keqardhje, dhe premtion se asnjëherë tjetër nuk do të përsërisë veprë të tillë apo të ngjashme.

Pokurori i shtetit u pajtua me pranimin e fajsisë nga i pandehuri, meqë pranimi është bërë në përputhje me dispozitën e nenit 248 të KPP, përkatësisht në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm me pasojat e pranimit të fajsisë dhe, pranimi është i mbështetur në provat e bashkangjitura kësaj propozim akuze, në fund i propozoi gjykatës që gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh shprehjen e keqardhejs së të pandehurit dhe faktin se në kohën e kryerjes së kësaj veprë, i njëjti ka qenë madhor i ri.

Pas deklaramit të të pandehurit se ndihet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe, pas marrjes edhe të mendimit të prokurorit, gjykata me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që është bindur se i njëjti, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që i përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Dhënie e ryshfetit nga neni 344 par 1 të KPK, dhe i shqiptoi vërejtje gjyqësore, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore, si ato lehtësuese dhe rënduese, si rrethanë veqanërisht lehtësuese pati parasysh pranimin e fajsisë, moshën e re të t'pandehurit në kohën e kryerjes së veprës, paraqitjen korrekte dhe të sinqertë në gjykatë, faktin se nga atëherë e deri më sot asnjëherë tjetër nuk ka kryer veprë tjetër penale, keqardhjen e shprehur dhe premtimin se edhe në të ardhmen nuk do të përsëris asnjë veprë të natyrës së tillë apo të ngjashme, peshën e veprës penale për të cilën parashihet dënim burgimi prej tre muajsh deri në tre vjet, andaj edhe organi i akuzës kishte ushtruar kërkesë për dhënie të urdhërit ndëshkimor, ndërsa gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë rënduese, prandaj duke patur parasysh gjitha këto rrethana që e bëjnë veprën veqanërisht lehtësuese, të pandehurit i shqiptoi vetëm vërejtje gjyqësore me bindje se këto rrethana e arsyetojnë qëllimin që ka vërejtja gjyqësore, e cila do të ndikojë që i pandehuri në të ardhmen të mos përsëris veprë penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 dhe 498 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**PKR.nr.287/15, me datë 27.10.2016**

**Sekretarja juridike**  
**Ardita Azemi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues,**  
**Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.